

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ARTGRES” SHPK



Ne Tirane, sot me daten, ditën e shtunë, shtetasi :

Z. Arti ELEZAJ, i biri i Aliut dhe i Vezikos, lindur me 20.05.1964 dhe banues ne Tirane, Rruga “ Llambi Bonata”, Pallati 11, Apartamenti Nr.34, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, me pasaporten Nr. Z 0773908, ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kutizuar, “ARTGRES ” shpk, Tirane Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga ortaku i vetem i shoqerise me emrin “ ARTGRES ” shpk, emertimi i të cilit do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise “ ARTGRES ” shpk eshte ne Picar - Vore.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithë juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim te ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit

Ortaku i Vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar te shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes se Vendimit të Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per njohjen dhe rregjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim të Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dërgohet menjehere per depozitim Gjykates kopetente per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.

NEN I 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaket e Shoqerise ose administratori i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria dhe terheqja e pjeseve të saj behet kur ceku Bankar eshte firmosur nga ortaket dhe Administratori i shoqerise, ne rastin kur ortaket caktojn nje administrator dhe vetem me firmen e ortakeve, kur ata vete kryejne njekohesisht dhe detyren e Administratorit të Pergjithshem të shoqerise.

NEN I 9

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet epjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 10

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj ne :

- Ndertime Civile, social kulturore, industriale, infrastrukture dhe çdo lloj tjeter investimi qe lidhet me fushen e ndertimit.
- Tregetin me shumice e pakice, importin dhe eksportin e te gjitha llojeve te pajisjeve per ndertim, te konstruksioneve te duroaluminit, hekurit dhe gjithshka qe lidhet me to.
- Prodhimin dhe tregetin, importin dhe eksportin e materialeve te ndertimit dhe t.e nenprodukteve te tyre
- Tregetin, importi dhe eksporti me shumice e pakice i te gjithe llojeve te prodhimeve ushqimore, konfeskioneve, veshmbathjeve, dhe te ngjashme me to, pajisjeve elektrike, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike.

NENI 11

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtimet të tjera të cilat jane me interes per mbarvajtjen e shoqerise.

NEN I 12

Me vendim të Asamblese se ortakeve, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.

NENI 13

Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji " Per shoqerite tregtare " i njej asamblese se ortakeve qe jane krijuar me ortakeri.

Ortaket mund t'ia delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 14


Adminsitratori i pergjithshem i shoqerise shpk, eshte Z. Arti ELEZAJ.

NENI 15

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njejta juridike dhe eshte i vlefshem kur vertetimi i autenticitetit të nenshkrimit eshte bere nga Noteri.

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE
"ARTGRES" SHPK

Z. Arti ELEZAJ

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Arti Elezaj', with a large, stylized flourish underneath.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 97 Rep.
Nr. 22 Kol.

NOTER

EMRI : RUKO SAKO

ADRESA: Bulevardi "Zog I", Pallati 12 katesh, Kati i dyte, mbrapa Cirkut te Tiranes.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 09.01.2006 (dymije e gjashte), ditën e Hene, para meje Noterit Publik Ruko SAKO, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi me kete identitet :

Z. Arti ELEZAJ, i biri i Aliut dhe i Vezikos, lindur me 20.05.1964 dhe banues ne Tirane, Rruga " Llambi Bonata", Pallati 11, Apartamenti Nr.34, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, me pasaporten Nr. Z 0773908.

Me vullnetin e tij të lire e të plote dhe të singerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e Administratorit te shoqerise "ARTGRES » dokumentin, drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per regjistrimin si person juridik të kesaj shoqerie tregtare dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen origjinale ne kete zyre dhe para meje Noterit. Une Noteri vertetoj rregullsin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij dokumenti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE

RUKO SAKO



S T A T U T
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
«ARTGRES» SH.P.K.



Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19 Nentor 1992 " Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise" dhe te akteve te tjera ligjore, ne Tirane, sot ne date 4 janar 2006, formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar nga Ortaku i Vetem , si vijon :

Z. Arti ELEZAJ, i biri i Aliut dhe i Vezikos, lindur me 20.05.1964 dhe banues ne Tirane, Rruga " Llambi Bonata", Pallati 11, Apartamenti Nr.34, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, me pasaporten Nr. Z 0773908.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ARTGRES" Sh.P.K. Tirane, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne ligjin Nr.7638 date 19 Nentor 1992 si dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesi i Shoqerise ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e shoqerise, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria "ARTGRES" Sh.P.K. Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.

Neni 5

Emri, Qendra , Territori

Emertimi i Shoqerise do te jete : Shoqeri private me Pergjegjesi te Kufizuar "ARTGRES" Sh.P.K.

Neni 6

Selia e Shoqerise do te jete ne Picar - Vore. Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjith territorin e Republikes Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 7

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Ndertime Civile, social kulturore, industriale, infrastrukture dhe çdo lloj tjeter investimi qe lidhet me fushen e ndertimit.

- Tregetimin me shumice e pakice, importin dhe eksportin e te gjitha llojeve te pajisjeve per ndertim te konstruksioneve te duroalunit, hekurit dhe gjithshka qe lidhet me to.
- Prodhimin dhe tregetimin, importin dhe eksportin e materialeve te ndertimit dhe t.e nenprodukteve te tyre
- Tregetimi, importi dhe eksporti me shumice e pakice i te gjithe llojeve te prodhimeve ushqimore, konfeskioneve, veshmbathjeve, dhe te ngjashme me to, pajisjeve elektrike, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike.

Neni 8

Afati i Veprimtarise

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare, mund te behet me lejen e organeve perkatese.

Neni 10

Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i Shoqerise "ARTGRES" Sh.P.K. perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleren prej 100.000 leke.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Neni 11

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne bashkeshortit, paraardhesve dhe pasardhesve.

Neni 13

Pjese te kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me miratim te ortakeve te shoqerise, ne rast te shtimit te numrit te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 pjese te kapitalit themeltar.

Neni 14

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, me marreveshje, pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis tyre.

Neni 15

Drejtimi Administrativ

Shoqeria « ARTGRES» Sh.P.K. do te kete si administrator Z.Arta Elezaj. Ortaku i shoqerise ka te drejte te caktojte si administrator edhe persona te tjere, te cilet nuk kane cilesine e ortakut.

Neni 16

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai mund te kryej te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Neni 17

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj te veprimtarise. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga

themeluesit e shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kopetencen e themeluesit te shoqerise.

Neni 18

Asambleja e ortakeve te shoqerise ka keto kompetenca :

- Me vota te vlefshme te shumices se kapitalit themeltar, ne rast te ndryshimeve te nevojshme te statutit, vendimi merret me $\frac{3}{4}$ e ortakeve.
- Te miratojne programin e shoqerise, te hartojne raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- Vendosin per shperberjen e shoqerise.
- Vendosin per fitimet dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullojne mardheniet e punesimit dhe shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas akteve ligjore shlyejne detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas apo te huaj.
- E te tjera.

Neni 19

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i Zgjedhur posacerisht nga Ortaket Themelues, keta te fundit miratojne aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe kane te drejte te informohen personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihen me llogarine dhe dokumentacionin e shoqerise.

Administratorit i jepen te gjitha kopetencat e administrimit te zakonshem te shoqerise, e drejta e perfaqesimit ligjor te saj me te trete dhe e gjykimit me aktet e administrimit te zakonshem, si te lidhe kontrata pune me te trete, te kryeje veprime me banken brenda limiteve, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate, te emeruje avokate, etj.

Neni 20

Per administrimin e te ardhurave te shoqerise gjat aktivitetit te saj do te caktohen specialiste kontabel per kryerjen e te gjitha veprimeve financiare, per evidentimin e te ardhurave te realizuara, fitimit si dhe detyrimeve. Ato do te evidentohen ne librat e llogarise. Ekspertet kontabel emerohen me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 21

Aktiviteti i shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te çdo viti. Bilanci duhet te shoqerohet nga nje relacion i asamblese se ortakeve qe sqaron mbarevajtjen e administrimit ne sektëre te ndryshem te aktivitetit te shoqerise duke i kushtuar nje vemendje te madhe investimeve, çmimeve dhe kostëve si dhe fakte te tjera te rendesishme te verejtura pas mbylljes se aktivitetit te periudhes.

NENI 22

Bilanci dhe relacioni i asamblese se ortakeve duhet te depozitohet prane selise se shoqerise 15 dite para mbledhjes se ortakeve qe do te thirren per ta aprovuar.

NENI 23

Shperndarja dhe likujdimi i shoqerise. Rastet e shperndarjes se shoqerise jane:

- Perfundimi i afatit te parashikuar per vazhdimin e saj.
- Arritja e objektivit te shoqerise ose pamundesia e arritjes se tij si dhe raste te tjera te parashikuara ne ligj.

NENI 24

Ne rast te shperndarjes se parakohshme te shoqerise, asambleja e ortakeve nga dita qe vendoset shperberja merr funksionin dhe pergjegjesine e likuidatorit me perjashtim te rasteve kur asambleja e ortakeve vendos ndryshe.

NENI 25

Ne rast se vendoset per likujdatore merret vendim nga asambleja e ortakeve me votim unanim.

NENI 26

Likujdatori brenda 6 muajve nga emerimi therret asamblene e ortakeve te cilit i paraqet raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise para fillimit te operacionit te likujdimit

NENI 27

Likujdatori perfaqeson shoqerine dhe gezon te gjitha kompetencat e domosdoshme per likujdimin e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise. Ai eshte i autorizuar te rimbursoje te gjitha kreditoret dhe tu shperndaje ortakeve mbetjet ne dispozicion.

NENI 28

Likujdatori ploteson raportin e kontabilitetit vjetor 3 muaj mbas mbylljes se vitit financiar ne baze te inventarit mbi elemente te ndryshem te aktivitetit dhe pasivitetit si dhe nje raport te shkruar mbi administrimin dhe gjithe operacionin e likujdimit.

NENI 29

Shperndarja e aktivitetit qe mbetet pasi kuotat e kapitalit baze do tu rikthehen ortakeve ose ortakut te vetem do tu shperndahen ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar.

NENI 30

Te gjitha mosmarreveshjet qe lindin midis shoqerise e te treteve apo midis ortakeve te saj n.q s nuk zgjidhen me mirekuptim palet kane te drejte tu drejtëhen per zgjidhje organeve gjyqesore


NENI 31

Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet ligji mbi shoqerite tregtare.

NENI 32

Stauti hartohet ne 4 kopje origjinale. Nje kopje depozitohet ne Zyren e Noterise Tirane, nje kopje ne Zyren e Regjistrimit Tregtar dhe nje kopje ne seline ligjore te shoqerise.

ORTAKU I VETEM
Z. Arti ELEZAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 98 Rep.
Nr. 23 Kol.

NOTER

EMRI : RUKO SAKO

ADRESA: Bulevardi "Zog I", Pallati 12 katesh, Kati i dyte, mbrapa Cirkut te Tiranës.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 09.01.2006 (dymije e gjashte), ditën e Hene, para meje Noterit Publik Ruko SAKO, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi me kete identitet :

Z. Arti ELEZAJ, i biri i Aliut dhe i Vezikos, lindur me 20.05.1964 dhe banues ne Tirane, Rruga " Llambi Bonata", Pallati 11, Apartamenti Nr.34, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, me pasaporten Nr. Z 0773908.

Me vullnetin e tij të lire e të plote dhe të singerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e Administratorit te shoqerise "ARTGRES » dokumentin, drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per regjistrimin si person juridik të kesaj shoqerie tregtare dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale ne kete zyre dhe para meje Noterit. Une Noteri vertetoj rregullsin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij dokumenti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE

RUKO SAKO

